

# Informacione të dobishme përpara vaksinimit

## Pasi të vaksinohem çfarë duhet të bëj?

- › Në varësi të vaksinës së dhënë, mund të jenë të nevojshme dy doza: Sigurohuni që keni takim të caktuar për dozën e dytë në qendrën e vaksinimit. Koha është e rëndësishme për të siguruar një shkallë të lartë të efikasitetit të vaksinës.
- › Imuniteti zhvillohet brënda javëve të para pasi që është bërë vaksinimi i plotë. Për këtë arsye ju nuk jeni nën mbrojtje të plotë kundër Covid-19!
- › Ekziston akoma mundësia për të infektuar të tjerët përreth jush me Covid-19. Vazhdoni të respektoni rregullat mbrojtëse.
- › Vazhdoni të merrni pjesë në Testimin e Shkallës të Gjerë, edhe pse tashmë jeni vaksinuar.

## Nëse shfaqen efekte(t) anësore çfarë duhet të bëj?

- › Vaksinat ashtu siç të gjitha ilaçet e tjera, mund të japin efekte anësore.
- › Efektet anësore me tepër të raportuara janë: dhimbje në vendin e injeksionit, lodhje, dhimbje koke, dhimbje trupi, të dridhura, dhimbje të kyçeve dhe temperaturë.
- › Nëse përjetoni një ose me shumë efekte anësore të **drejtohuni mjekut ose farmacistit tuaj**. Kjo vlen për çdo efekt anësor që dyshoni se ka të bëjë në lidhje me vaksinën që ju është bërë. Gjithashtu efektet anësore në fjalë ju mund ti deklaroni përmes sistemit kombëtar të deklarimit: <https://gd.lu/3DL2gh>
- › Broshura për vaksinën mund ta gjeni në [covidvaccination.lu](https://gd.lu/3DL2gh) brënda seksionit **InfoVAXX**.

Mos i ndryshoni zakonet tuaja, vazhdoni të zbatoni **masat mbrojtëse**



## Te dhënat në lidhje me trombozat

**Vaksinimi me Vaxzevria® (AstraZeneca) ose Janssen (Johnson & Johnson) ka një probabilitet rreziku shumë të vogël tromboze**

Tek njerëzit që kanë marrë vaksinën Vaxzevria® ose Janssen, ka ndodhur rasti i mpiksjes së pazakontë të gjakut me numër të ulët të trombociteve.

Rreziku i një efekti anësor të tillë është shumë i ulët, por gjithsesi duhet të jeni vigjilent për çdo simptomë, në mënyrë që të merrni trajtim të shpejtë mjekësor për të ndihmuar shërimin dhe për të shmangur ndërlikimet.

**Cilat janë simptomat e mundshme të trombozës të shkaktuara nga vaksinimi?**

- › Gulçim në frymarrje
- › Dhimbje në krahavar
- › Këmbë të fryera
- › Dhimbje të vazhdueshme abdominale (të barkut)
- › Simptoma neurologjike të tilla si, dhimbje koke e rëndë dhe e vazhdueshme ose shikim i paqartë
- › Njolla të vogla të gjakut nën lëkurë përtej vendit të injektimit

**Çfarë duhet të bëj nëse i vërej këto simptoma?**

Në javët që vijojnë pas injektimit tuaj nëse përjetoni një nga nga simptomat e lartpërmendura duhet të konsultoheni menjëherë me një mjek të urgjencës. Ju lutemi kontaktoni mjekun tuaj të familjes. Ju gjithashtu mund të kontaktoni edhe grupet e gatshme të shërbimit mjekësor.

**Në rast urgjence telefononi 112'tën.**

Gjithashtu mund të deklaroni efektet anësore të padëshirueshme

nëpërmjet sistemit kombëtar të deklarimit: <https://gd.lu/3DL2gh>